



---

**KONKURS**  
**PËR POZITËN**  
**E EKSPERTIT JO-KYÇ 2**  
**“ZYRTAR I PROJEKTIT ME PROFIL FINANCIAR”**  
**PËR**

**PROGRAMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II**  
**MES KOSOVËS DHE ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË 2014-2020**

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Republikës së Kosovës në cilësinë e Strukturës Operative, në marrëveshje me Strukturën Operative nga Ministria për Vetë-Qeverisje Lokale e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë bëjnë thirrje publike për shprehje të interesimit në mënyrë që të vazhdohet me rekrutimin e një (1) Zyrtari të Projektit me profil financiar për zbatimin e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar të IPA II mes Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë 2014-2020

Përgjegjësit e Ekspertit jo-Kyç (EJK) do të jenë të drejtuara ndaj projektit dhe financave. Përveç detyrave të Zyrtarit të projektit (të cilat duhet të zvogëlohen në krahasim me ato të ekspertit të mëparshëm jo-kyç), kjo pozitë specifike duhet të trajtoj edhe zbatimin e programit (sidomos në çështjet financiare në zbatimin e kontratave të grantit), menaxhimin financiar të kësaj kontrate të shërbimeve si dhe në çështjet administrative. Zyrtari do të kryej detyrat e tij/saj në objektet e SPT në Gjilan.

Zyrtari i projektit me profilin financiar është një pozitë që përfshinë deri në **460** ditë pune për kohëzgjatjen e kontratës. Minimalisht 75% e këtyre ditëve të punës duhet të kalohen në territorin e pranueshëm. Përveç detyrave të zyrtarit të projektit dhe çështjeve administrative, ai/ajo do të jenë përgjegjës/e për menaxhimin financiar, rrjedhën dhe transaksionin e fondeve si dhe vërtetimin e shpenzimeve të projektit në përputhje me kontratën dhe rregullat përkatëse të PRAG. Ai/ajo do të mbështesin Udhëheqësin e SPT dhe do raportojnë kurdo që është e nevojshme tek SO dhe AK mbi menaxhimin financiar të kësaj kontrate për shërbime. Të gjithë kandidatët e interesuar mund të dorëzojnë aplikacionet për pozitën e përshkruar më poshtë:

**Përvoja e përgjithshme, kualifikimet, shkathtësitë:**

- Diplomë universitare, preferohet edhe diploma e nivelit Master, dhe së paku 5 vjet përvojë punë profesionale ;
- Rrjedhshmëri në shkrim dhe në të folur në gjuhën angleze si dhe në gjuhën kombëtare të Kosovës;
- Njohuri mbi rregullat e PRAG.

**Përvoja e përgjithshme profesionale**

- Së paku 3 vjet përvojë të përgjithshme profesionale në programet/projektet e asistencës të financuara nga BE-ja apo donatorët e tjerë, dhe
- Së paku 2 vjet përvojë në menaxhimin financiar dhe administrativ të projekteve në sektorin publik apo privat.



### **Përvoja specifike profesionale**

- Së paku 3 vjet përvojë me programet/projektet e financuara nga BE-ja, ku përparësi kanë çështjet që ndërlidhen me bashkëpunimin ndër-kufitar mes përfituesve të IPA II;
- Përvojë në menaxhimin financiar dhe administrativ të projektit, prokurim, nën-kontraktim, buxhetim, raportim financiar, menaxhim të resurseve;
- Përvoja në ofrimin e trajnimeve të ndërlidhura me menaxhimin financiar dhe administrativ të projektit është përparësi;
- Përvoja si konsulent për administrimin financiar dhe prokurimin në projektet e financuara nga donatorët ndërkombëtar, e veçanërisht programet e BNK të financuara nga BE-ja, është përparësi.

Zyrtari financiar duhet të ketë shtetësinë e Kosovës.

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Curriculum Vitae (CV) në gjuhën angleze në formatin Europass;
- Letrën motivuese në gjuhën angleze;
- Të gjitha dokumentet relevante mbështetëse që duhet dorëzuar me rastin e aplikimit (referencat, diplomat e noterizuara, letërnjoftimi, vërtetimin që nuk jeni nën hetime dhe dëshminë se nuk keni borxhe në Administratën Tatimore të Kosovës).

Aplikacioni duhet të dorëzohet drejtpërdrejt me post apo e-mail në adresën e mëposhtme nga data 15 - 24 nëntor 2016.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ish-Ndërtesa e Rilindjes, Kati 11, Prishtinë, Kosovë

**E-mail: [hazbije.kelmendi@rks-gov.net](mailto:hazbije.kelmendi@rks-gov.net)**